

**Nr. Prot. 037/B/18**

**VENDIM Nr. 1225**

**Për**

**Vazhdimi e Procesit të Konsultimit Publik të**

**“Planit për Hapjen e Brezeve”**

Në mbështetje të nenit 3, paragrafët 1) dhe 2), nenit 9, paragrafi 3.6), nenit 10, paragrafi 4) dhe 12), nenit 45 paragrafët 1) dhe paragrafi 2), nenit 54 paragrafi 1), paragrafi 2) dhe paragrafi 4), nenit 79 paragrafët 1) dhe 2) dhe neni 82 paragrafi 1) dhe 3) të Ligjit për Komunikimet Elektronike Nr. 04/L-109 (*tutje referuar si – Ligji ose LKE*) dhe nenit 11 paragrafi 3.3) dhe nenit 13 paragrafi 1) dhe 5) i Statutit të Autoritetit Rregullativ të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (*tutje referuar si – Autoriteti ose ARKEP*), Bordi i Autoritetit i përbërë nga:

- |                       |         |
|-----------------------|---------|
| 1) z. Kreshnik Gashi, | Kryetar |
| 2) z. Nijazi Ademaj,  | Anëtar  |
| 3) z. Hazir Hajdari,  | Anëtar  |
| 4) z. Bahri Anadolli, | Anëtar  |

në mbledhjen e 29-të me radhë të mbajtur më datë 22 Qershor, 2018 pas shqyrtimit të Kërkesës së operatorit IPKO Telecommunications LLC, vendosi si më poshtë:

**V E N D I M**

- I. Miratohet vazhdimi i konsultimit publik të dokumentit: **“Plani për Hapjen e Brezeve”**.
- II. Vazhdohet procesi i konsultimit publik nga data **07 Korrik 2018** deri më datë **01 Gusht 2018**.
- III. Ky vendim është përfundimtar dhe hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

**A R S Y E T I M**

Ligji, respektivisht neni 10 (*Kompetencat e Autoritetit*) përkufizon kompetencat e Autoritetit për menaxhimin e resurseve dhe rregullimin e tregut të komunikimeve elektronike.

Neni 45, paragrafi 2) i Ligjit përcakton se: *“Spektri frekuencor (kanalet) do të menaxhohet duke u bazuar në Planin Kombëtar të Radio – frekuencave dhe Planin për përdorimin e radio – frekuencave (kanaleve) konform planeve zhvillimore për radio komunikime.”*

Neni 54, paragrafi 2) i Ligjit përcakton se ARKEP vendos kushtet për shfrytëzimin e radio-frekuencave.

Neni 82 i Ligjit përkufizon se Autoriteti gjatë aprovimit të akteve normative duhet t’i publikojë ato në pajtim me kushtet dhe procedurat e vendosura nga Autoriteti, duke ua ofruar mundësinë personave të interesuar që në afat të arsyeshëm kohor të shprehin pikëpamjet e tyre.

ARKEP me Vendimin nr.1196 (Ref. Nr.Prot.032/B/18) të datës 23 Maj 2018 ka filluar procesin e konsultimit publik të draft dokumentit *“Plani për Hapjen e Brezeve”*. Sipas vendimit në fjalë periudha e konsultimit publik ka qenë nga 23 Maj 2018 deri më 06 Korrik 2018.

Draft dokumenti *“Plani për Hapjen e Brezeve”* përshkruan në mënyrë të detajuar Kornizën rregullatore në Republikën e Kosovës dhe Bashkimin Evropian (BE) lidhur me brezet frekuencore me vlerë të posaçme ekonomike për shërbimet IMT, kapacitetet e frekuencore të disponueshme në Republikën e Kosovës për secilin brez, pasqyrën e tregut të komunikimeve elektronike me fokus në tregun e telefonisë mobile, si dhe janë parashtruar një numër i konsiderueshëm i pyetjeve për palët e interesit ashtu që procesi të administrohet sa më mirë.

Më datë 12 Qershor 2018 operatori IPKO Telecommunications LLC ka dërguar shkresë në ARKEP (Ref. e-mail: Tuesday, June 12 2018 1:42 PM), përmes së cilës ka kërkuar që të shtyhet afati i konsultimit deri në fund të muajit Korrik. Arsyet e kërkesës për shtyrje është se duhet të koordinohen me kompaninë amë dhe kjo periudhë është kryesisht periudhë pushimesh.

Prandaj, në përmbushje të objektivave të përcaktuara në:

- Ligjin Nr.04/L-109 për Komunikimet Elektronike, i cili rregullon aktivitetet e komunikimeve elektronike, përfshirë këtu menaxhimin e resurseve frekuencore bazuar në neutralitetin teknologjik dhe Kornizën Rregullatore të BE-së,
- Politikat e Sektorit të Komunikimeve Elektronike *“Agjenda Digjitale për Kosovën 2013-2020”* për zhvillimin e rrjeteve të komunikimeve elektronike brezgjëra në tërë territorin e Republikës së Kosovës,

ARKEP ka vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.

### **Këshilla Juridike;**

Pala e pakënaqur me këtë vendim mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimit të Vendimit.

**Prishtinë, 04/07/2018**

**Kreshnik Gashi**  
**Kryetar i Bordit**

**Aktvendimi i dërgohet:**

- Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik,
- Autoritetit Kosovar të Konkurrencës,
- Komisionit të Pavarur për Media,
- Ndërmarrjeve të Rrjeteve dhe/ose Shërbimeve Publike të Komunikimeve Elektronike
- Arkivës së Autoritetit.